

Trajnimi “Analizat Sasiore”, zhvilluar pranë Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë

Në datat 26-27 Shtator 2022, Kontrolli i Lartë i Shtetit, mori pjesë në trajnimin mbi “*Analizat Sasiore*”, zhvilluar pranë Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë.

Në këtë trajnim Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga: Megi Kurushi, Audituese e Lartë në Departamentin e Auditimit të Performancës, Krisi Anastas, Auditues i I në Departamentin e Auditimit të Performancës, znj. Safete Pojani, Audituese e I në Departamentin e Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional dhe Jon Kraja, Auditues i II në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore. Ky trajnim pati konsiderata të veçanta në shkëmbimin e njohurive dhe njohjes së dallimeve që ekzistojnë mes dy institucioneve tona në auditimin e performancës dhe nevojën që kanë audituesit tanë në përsosjen e njohurive statistikore, për të garantuar saktësi dhe kompetencë, në të dhënat që pasqyrojnë në raportet e auditimit.



Gjatë ditës së parë të trajnimit, në bashkëpunim dhe me auditues të Zyrës së Auditimit të Kosovës, u përfunduan njohuri në aspektin e analizave sasiore dhe atyre statistikore, veçanërisht në menaxhimin dhe përdorimin e masave sasiore, të nevojshme për këto lloj analizash. Një hapësirë e veçantë gjatë trajnimit, iu kushtua dhe mbledhjes së të dhënave dhe mënyrës si duhet të kërkohen të dhënat e duhura, për të paraqitur rezultatin e duhur, varësisht problematikës që trajtohet.

Rëndësi në trajtim iu dha gjithashtu menaxhimit të të dhënave dhe kriterëve që këto të fundit duhet të plotësojnë si: *vlefshmëria, besueshmëria, plotësia, saktësia dhe integriteti*. Gjatë trajnimit, u zhvilluan dhe seanca praktike duke angazhuar pjesëmarrësit në punën në grup.

Gjatë ditës së dytë, trajnimi ishte më i dedikuar në aspektin praktik duke dhënë orientimet e përdorimit të formulave përlllogaritëse në Excel dhe tabelave Pivot. Kryesisht gjatë ditës së dytë fokusi ishin ushtrimet në grup, për të pasur më të qartë funksione të caktuara në Excel dhe njohuri bazike në fushën e statistikave.